

10 vendet

më të vizituara në botë

World Tourism Organisation, një organizatë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila merret kryesisht me statistikat mbi turizmin botëror, por jo vetëm, ka publikuar së fundmi raportin e vitit 2022. Ky raport, i cili konsiderohet më i sakti në rang botëror, paraqet qartazi 10 destinacionet më të vizituara të renditura sipas vizitorëve internacional të ardhur vjetor.

Barometri i Turizmit Botëror, siç titullohet publikimi, tregon se në vitin 2022 kishte rreth 936 milion vizitor në të gjithë botën duke u dalluar një rënie me 10% nga viti 2021, por një rritje e ndjeshme nga viti 2019 me 142%.



10.Meksika

Në vendin e dhjetë është Meksika me 26,2 milion vizitorë. Ajo dallon për një diversitet në turizmin e saj, i cili varion nga plazhet e mrekullueshme tek rrënojat e qyteteve antike apo kuzhina e pasur.



9.Turqia

Me 27.8 milion vizitorë Turqia është renditur e nënta. Historia, kultura dhe bukuritë natyrore janë faktorët kyç të cilët e bëjnë Turqinë një nga vendet më të vizituara.



8.Austria

Me një rritje prej 34% nga viti 2021, Austria numëron 28.4 milion vizitorë. Ajo ofron panorama magjepëse, qytete historike si Viena dhe Saltzburgu, pasuri kulturore, edhe një turizëm blu mjaft të zhvilluar.



7.Mbretëria e Bashkuar

Në vendin e shtatë qëndron Mbretëria e Bashkuar me 32,6 milion vizitorë, ku dallohet një rritje me 12% nga viti 2021. Ajo i mirëpret vizitorët me atraksione turistike shumë të njohura si Big Ben apo Buckingham Palace, vende historike vërtetë interesante si Stonehenge etj.



1.Franca

Triumfuese në këtë renditje shpallet Franca me plot 92.4 milion vizitorë në vitin 2022. Ajo zë këtë vit vendin e parë ndryshe nga viti 2021, në të cilin renditej e treta. E lagur në pjesën më të madhe të perimetrit të saj nga uji, ajo i ofron turistit botëror një shumëllojshmëri turizmesh duke dalluar kryeveprat botërore dhe monumentet të cilat shpalosin historinë e bujshme të saj.



2.Italia

Ndryshe e quajtur si "cizmja italiane" është vendi i dytë më i vizituar për vitin 2022. Ajo numëron 82,7 milion turistë ku më shumë se 50 milion vijnë vetem nga Europa. Italia është vendi ku në të 360 gradet e saj mund të gjesh arsye për ta vizituar.



3.SHBA

Kryesisht nga pertej oqeanit SHBA-ja zë vendin e tretë si më e vizituara me 73.9 turistë ndërkombëtar. Las Vegas apo North Dakota mjaftojnë për tu përmendur si indikator të këtij turizmi masiv.



4.Spanja

56.2 milion turistë zgjodhën Spanjën në shumëllojshmërinë që ajo ofron në shumë aspekte. Arkitektura spanjolle vlen për tu përmendur



5.Greqia

Vendi i 940 ishujve renditet e pesta me 53 milion vizitore. Dallohet gjithashtu një ulje me 5% nga viti 2021. Turizmi blu luan një rol themelor në Greqi, por edhe ai kulturor nuk mbetet pas.



6.Gjermania

Gjermania numëron, me një rritje me 23%, 41,3 milion vizitorë në vitin 2022. Ndër pikat kyçe të turizmit të saj kulturor mund të përmendim Bavarinë apo Köln-in.

